- Dhënia e shërbime lidhur me qëllimin e shoqërisë,
- Pjesëmarrja në dhe themelimi i shoqërive me qëllim social të ngjashëm.

2.1. Shoqëria ka të drejtë të ndërmarrë gjithë veprimet dhe masat të cilat drejtpërdrejtë apo tërthorazi janë të përshtatshme për promovimin e qëllimit të korporatës si më lart, përfshirë por duke mos u kufizuar në:

- a) Të lidhë çdo lloji kontrate apo marrëveshje me persona fizikë apo juridikë publik dhe privat, shoqëri, shtetin, entitete të huaja apo shqiptare;
- b) Të themelojë gjithë llojet e shoqërive apo të marrë pjesë në shoqëri apo sipërmarrje të përbashkëta të huaja apo shqiptare apo në lloje të ndryshme biznesi me objekte të njëjta apo të ngjashme;



- c) Të themelojë degë dhe agjenci në Shqipëri apo jashtë shtetit;
- d) Të përfaqësojë biznese shqiptare apo të huaja lidhur me fushën e veprimit të Shoqërisë;
- e) Të lidhë marrëveshje huaje, të pranojë garanci personale apo të tjera, të marrë përgjegjësi apo tituj kolateralë të tjerë;
- f) Të kryejë çdo veprim tregtar, industrial, financiar dhe transaksione të tjera të lidhura me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të cilat mund të konsiderohen të nevojshme apo të përshtatshme për arritjen e qëllimit të korporatës; dhe
- g) Të ndërmarrë çdo aktivitet tregtar apo të lidhur me të dhe të kryejë çdo veprim ligjor apo transaksion drejtpërdrejt apo tërthorazi lidhur me fushën e veprimit të shoqërisë, apo që drejtpërdrejtë ose tërthorazi ka për qëllim përmbushjen e qëllimit të Shoqërisë.

### 3. Kapitali Aksionar dhe Kontributet në Kapital

#### 3.1. Kapitali i kuotave I shoqërisë është

100 Leke Shqiptarë (me fjalë: një qind)

Kapitali do të paguhet në mjete monetare brenda gjashtë muajve pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit në llogarinë bankare të hapur në çdo bankë në Shqipëri.

3.2. Mbjajtësit e kuotave mund të rrisin kontributin e tyre në kapitalin e regjistruar. Një rritje e kapitalit mund të bëhet nga rritja e vlerës nominale të aksioneve ekzistuese ose në ndonjë mënyrë tjetër e parashikuar nga ligji. Kontributet mund të jenë në mjete monetare ose në ndonjë formë tjetër të lejuar nga ligji, duke përfshirë kontributet në natyrë.

3.3. Metodat e rritjes së kapitalit dhe kushtet e pagimit të kontributeve nga mbajtësit e kuotave vendosen rast pas rasti, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

3.4. Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë, do të vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare.

#### 4. Kuotat

##### 4.1. Kuotat do të ndahen si në vijim:

- Shkej (Shoqata Kombëtare Edukim Për Jetën) Tiranë, Shqipëri: 1 kuotë e cila përfaqëson 51% (51 Lekë) e kapitalit aksionar të Shoqërisë, dhe

- Gragger & Cie Social Business GmbH, Traunuferstraße 150, 4052 Ansfelden, Austri: 1 kuotë e cila përfaqëson 49% (49 Lekë) të kapitalit aksionar të Shoqërisë.

### 5. Kohëzgjatja e Shoqërisë, viti financiar

Shoqëria themelohet për një periudhë të pacaktuar.

Viti financiar është viti kalendarik. Viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon në 31 Dhjetor të të njëjtit vit.



## II. Menaxheri

### 6. Përfaqësimi i Shoqërisë

6.1. Shoqëria ka një ose më shumë drejtorë menaxhues (administratorë) të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat që nuk kalon 2 (dy) vjet me një shumicë të cilësuar prej 75% të votave të mbajtësve të kuotave të pranishëm ose të përfaqësuar në mbledhje. Nëse është emëruar vetëm një drejtor menaxhues, ai/ajo përfaqëson shoqërinë i/e vetëm. Nëse janë emëruar disa drejtorë menaxhues, shoqëria përfaqësohet nga dy drejtorë menaxhues së bashku ose nga një drejtor menaxhues së bashku me një nënshkruar të autorizuar, përveç nëse parashikohet ndryshe në këtë Statut ose me vendim të mbajtësve të kuotave të arritur më shumicën e kualifikuar të votave, 75% e votave të mbajtësve të kuotave të paraqitur në mbledhje.

6.2. Asambleja e përgjithshme mund, edhe nëse janë caktuar disa drejtorë menaxhues, të japë, herë pas here, për veprime specifike, kompetenca individuale të përfaqësimit në mënyrë të pavarur prej tyre ose të vendosë për rregullore të veçanta të përfaqësimit.

6.3. Drejtori Menaxhues i Shoqërisë do të ushtrojë kompetencat dhe do të kryejë detyrat e zyrës së tij / saj me ndershmëri, në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të Shoqërisë, dhe në lidhje me të do të ushtrojë shkallën e kujdesit të duhur dhe aftësive që një person i matur në mënyrë të arsuiyeshme do të ushtronte në rrethana të krahasueshme. Është përgjegjësia e Drejtorit Menaxhues të mësojë ai/ajo vetë detyrimet ligjore dhe rregullore që lidhen me cilësinë e tij/sai si drejtor i shoqërisë, duke qenë veçanërisht i vëmendshëm për detyrimet e mundshme personale të lidhura, ndër të tjera, me çështjet e punësimit dhe taksat.

6.4. Drejtori i parë menaxhues (administratori) i Shoqërisë për 2 (dy) vjet është:

Znj. Zamira Muca, shtetase shqiptare, lindur në Pukë më 17.02.1977, mbajtëse e pasaportës nr. BD8383484 dhe me nr. personal H75217051U, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

### 7. Veprime juridike të cilat kërkojnë miratim

7.1. Menaxheri kërkon pëlqimin paraprak të të gjithë mbajtësve të kuotave në mënyrë që të kryejë veprime ligjore dhe të ndërmarrë masa jashtë veprimtarisë së zakonshme të Shoqërisë dhe për veprime ligjore dhe masat si më poshtë:

7.1.1. eliminimi i gjithë apo pjesë të pasurive të Shoqërisë

7.1.2. themelimi dhe përfundimi i shoqërive apo sipërmarrjeve, blerje apo tërheqje e pjesëmarrjeve në sipërmarrje të tjera (këtu e më poshtë referuar si "shoqëri me pjesëmarrje")

7.1.3. themelimi, blerja, mbyllja apo tërheqja e shoqërive të themeluara, degëve apo filialeve;

7.1.4. Blerja, shitja apo barrësimi i pasurive të paluajtshme apo të drejtave të barabarta me ato të pasurive të paluajtshme, tërheqja nga të drejta mbi pronësi industriale;

7.1.5. Emërimi apo largimi i nënshkruarve të autorizuar dhe përfaqësuesve të autorizuar për gjithë veprimtarinë e biznesit;

7.1.6. Mbyllja dhe përfundimi i marrëveshjeve të patentave, licencave dhe njohurive teknike;

7.1.7. Mbyllja dhe përfundimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me volum më të lartë se 50,000 euro (pesëdhjetë mijë euro) në vit;



7.2. Për aq kohë sa blerja, shitja dhe barrësimi të objekteve si më lart kërkojnë miratim edhe veprimet e detyrueshme kërkojnë miratim. Ky i fundit mund të japë pëlqimin e tij paraprak për disa grupe apo lloje veprimesh dhe masash.

7.3. Menaxheri është i detyruar të përpiqet për të siguruar që dispozitat e këtij neni 7 të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjitha shoqëritë të tanishme dhe të ardhshme ku ka shumicën e pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta të Shoqërisë për aq sa është e mundur ligjërisht dhe praktikisht.

8. Detyrimet e informimit ndaj mbajtësve të kuotave

8.1. Menaxheri duhet të përgatisë dhe raportojë rregullisht te mbajtësit e kuotave për ecurinë e biznesit dhe të gjitha ngjarjet e rëndësishme në lidhje me shoqërinë. Në këtë drejtim, mbajtësit e kuotave duhet të pajisen me informacionin dhe dokumentet e mëposhtme në veçanti:

8.1.1. Raportet krahasuese tremujore të rezultateve synuara / aktuale dhe statusin e likuiditetit

8.1.2. Raporti mujor teknik dhe i zbatimit;

8.2. Menaxheri ka detyrimin të përgatisë një plan biznesi duke përfshirë një buxhet vjetor për vitin e ardhshëm financiar së paku 2 (dy) muaj para përfundimit të çdo viti financiar dhe t'ia paraqesë atë mbajtësve të kuotave për aprovim. Kjo vlen edhe për filialet dhe për buxhetin të konsoliduar

9. Shkarkimi i menaxherit

Asambleja e Përgjithshme vendos shkarkimin e menaxherit në vendimin e miratimit të pasqyrave financiare vjetore dhe të propozimit të bilancit dhe shpërndarjes së fitimit.

### III. Asambleja e Përgjithshme

10. Detyrat dhe të drejtat e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për të gjitha çështjet e shoqërisë që nuk i janë caktuar shprehimisht një organi tjetër me ligj, nga ky Statut ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

11. Mbledhje dhe vendime

11.1. Asambleja e Përgjithshme mbahet rregullisht në zyrën e regjistruar të Kompanisë. Asambleja e Përgjithshme emëron një kryetar ("Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme") me shumicë të thjeshtë, i cili drejton diskutimin dhe votimin dhe i cili më pas emëron një sekretar.

11.2. Çdo Asamble e Përgjithshme do të thirret nga një Drejtor Menaxhues, ose nga një mbajtës i kuotave në përputhje me nenin 84 të Ligjit për Shoqëritë, me postë rekomande ose e-mail për secilin mbajtës të kuotave në adresat e fundit të njoftuara me shkrim ndaj Shoqërisë dhe jo më vonë se 2 (dy) javë para mbledhjes. Periudha e njoftimit fillon ditën pas ditës së dërgimit të thirrjes përmes postës rekomande ose postës elektronike. Dita e mbledhjes nuk llogaritet në llogaritjen e ditëve të periudhës së njoftimit. Njoftimi do të mbajë datën, kohën dhe vendin e mbledhjes, si dhe pikat që do të diskutohen (rendi i ditës) dhe, në rast të një Asambleje të Përgjithshme të Zakonshme, ajo do të përfshijë përveç kësaj pasqyrat e plota vjetore financiare dhe raportin e menaxhimit.

11.3. Një mbajtës i kuotave mund të marrë pjesë në një Asamble të Përgjithshme me anë të thirrjes telefonike, video konferencës ose duke përdorur forma të ngjashme përmes pajisjeve të komunikimit të cilat mundësojnë që të gjithë personat që marrin pjesë në mbledhje dhe të dëgjojnë dhe flasin me njëri-tjetrin gjatë mbledhjes. Një person që merr pjesë në këtë mënyrë konsiderohet të jetë i pranishëm në mbledhje dhe llogaritet në kuorum



me të drejtë vote. Prania në mbledhje dhe votimi i mbajtësve të kuotave raportohet rregullisht në procesverbalin e mbledhjes.

11.4. Investitori, specifikisht Caritas St. Pölten, duhet të njoftohet dhe lejohet të marrë pjesë në mbledhjen e mbajtësve të kuotave në përputhje me marrëveshjet e lidhura midis mbajtësve të kuotave dhe investitorit. Investitori nuk lejohet të votojë por mund të japë vetëm mendim dhe këshilla.

11.5. Me pëlqimin e të gjithë mbajtësve të kuotave, Asambleja e Përgjithshme gjithashtu mund të miratojë vendime me efekt juridik pa respektuar format dhe afatet e mësipërme, me kusht që të gjithë mbajtësit e kuotave të paraqiten ose të përfaqësohen dhe të heqin dorë nga format dhe afatet e përcaktuara në statut. Në të njëjtën mënyrë, vendimet me shkrim mund të transmetohen në forme shkresore, me faks ose e-mail nëse të gjithë mbajtësit e kuotave marrin pjesë në marrjen e vendimit dhe asnjë mbajtës i kuotave nuk kundërshton mënyrën në të cilën merret vendimi. Mbajtësit e kuotave marrin vendime rreth propozimeve të paraqitura brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumentit që përmban tekstin e vendimit, duke i kthyer brenda kësaj periudhe një kopje origjinale të nënshkruar të dokumentit drejtorit menaxhues të Shoqërisë dhe me e-mail një kopje elektronike të saj.

11.6. Një mbledhje e përgjithshme ka një kuorum nëse 75% e kapitalit aksionar është i pranishëm ose i përfaqësuar. Në mungesë të kuorunit, një mbledhje e re me të njëjtin rend të ditës duhet të thirret menjëherë, e cila quhet se ka kuorum në rast se mbajtësit e kuotave të pranishëm, personalisht ose me prokurë, mbajnë më shumë se tridhjetë për qind (30%) të të drejtave të votës në Shoqëri, përveç nëse mbledhja thirret për të vendosur mbi çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimin e Statutit, shpërndarjen e fitimeve, rritjen ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, ristrukturimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë, rast në të cilin kuorumi duhet të jetë më shumë se pesëdhjetë për qind (50 %).

11.7 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme miratohen nga shumica e thjeshtë e mbajtësve të kuotave pjesëmarrëse, përveç nëse një shumicë e cilësuar kërkohet nga ligji, nga ky Statut ose nga marrëveshja midis mbajtësve të kuotave, nëse ka. Të drejtat e votimit bazohen në shumën nominale të kontributit në kapital të përfaqësuar.

11.8. Përveç të drejtave të tjera të parashikuara në këtë Statut dhe/ose në Ligjin për shoqëritë tregtare, Asambleja e Përgjithshme merr vendime posaçërisht për çështjet e mëposhtme:

11.8.1. Miratimin e marrëveshjeve ndërmjet shoqërive

11.8.2. Përcaktimin e hapjes së bilancit të likuidimit, pasqyrës vjetore të likuidimit

11.8.3. Eliminimin e gjithë apo pjesë të pasurive të Shoqërisë;

11.8.4. Blerjen, shitjen apo barrësimin e pasurive të paluajtshme apo të drejtave të barabarta me ato të pasurive të paluajtshme, tërheqja nga të drejta mbi pronësi industriale;

11.8.5. Amendimet ndaj Statutit, përfshirë miratimin e vendimeve për bashkimin, ndarjen apo ndryshimin e formës ligjore të Shoqërisë bazuar në ligjin për shoqëritë tregtare;

11.8.6. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore të propozuara nga menaxheri;

11.8.7. Shpërndarjen e fitimeve vjetore; transferimin e vlerave të fitimeve në rezervat, rritjen apo zvogëlimin e rezervave dhe rritjen e kapitalit nga fondet e shoqërisë;

11.8.8. Shkarkimin e menaxherit dhe emërimin e audituesit;



11.8.9. Emërimin dhe shkarkimin e drejtorëve menaxhues, përfshirë mbylljen, amendimin dhe përfundimin e kontratave të punësimit të drejtorëve menaxhues;

11.8.10. Vendimeve sipas pikës 6.2. (modifikimi i Prokurës)

11.8.11. Miratimin e masave të menaxhimit të cilat janë subjekte të miratimit të Asamblesë së Përgjithshme;

11.8.12. Miratimin e planit vjetor në veçanti planifikimin e buxhetit për vitin financiar të ardhshëm;

11.8.13. Lidhja e marrëdhënieve me shoqëri të çdo lloji, përfshirë marrëveshjeve të heshtura dhe gjithë marrëveshjeve të cilat i japin palës tjetër në kontratë një kuotë në fitimin e Shoqërisë apo një shpërbllim varësisht shumës së fitimeve.

## 12. Thirrja

12.1. Mbledhja e mbajtësve të kuotave do të mbahet së paku dy (2) herë në vit gjatë çdo viti financiar të Shoqërisë.

12.2. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme mbahet pas përgatitjes së pasqyrave vjetore financiare dhe, nëse kërkohet një auditim, kur raporti i audituesit të jetë i disponueshëm. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme merr vendime lidhur me:

12.2.1. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore të propozuara nga menaxheri;

12.2.2. Përvetësimi i fitimeve të pashpërndara;

12.2.3. Shkarkimin e menaxherit dhe, nëse e përshtatshme, me organet e tjera ekzistuese;

12.2.4. Nëse e nevojshme, zgjedhja e audituesit për vitin e ardhshëm financiar;

12.2.5. Pika të tjera të rendit të ditës.

12.3. Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme do të thirret çdo herë që:

12.3.1. Menaxheri e konsideron të nevojshme për interesin e Shoqërisë, apo

12.3.2. Mbajtësit e kuotave së paku të 5% të kapitalit aksionar të shoqërisë kërkojnë mbledhjen.

## 13. Transkriptimi

13.1. Procesverbali do të mbahet në çdo Asamble të Përgjithshme. Proces-verbali duhet të përmbajë:

13.1.1. Datën, vendin dhe kohën e mbledhjes;

13.1.2. Emrat e mbajtësve të kuotave të pranishëm apo të përfaqësuar;

13.1.3. Rendin e ditës dhe propozimet;

13.1.4. Rezultatit e votës dhe formulimin e vendimeve që janë marrë;

13.1.5. Informacionin lidhur me ekzekutimin e kërkesave të tjera.

13.2. Procesverbali duhet nënshkruar nga kryetari i Asamblesë së Përgjithshme dhe sekretari, i cili mund edhe të jetë Noter.



#### 14. Përfaqësimi në Asamblëtë e Përgjithshme

14.1. Secili mbajtës i kuotave mund të përfaqësohet në miratimin e vendimeve. Përfaqësuesit duhet të identifikojnë veten e tyre me prokurë me shkrim.

14.2. Mbajtësit e kuotave që nuk janë as të pranishëm dhe as të përfaqësuar në Asamblenë e Përgjithshme duhet të informohen menjëherë për çdo vendim të miratuar me njoftim marrje të vendimit.

#### IV. Përvetësimi i fitimeve

##### 15. Pasqyrat vjetore

15.1. Pasqyrat vjetore financiare, raporti i menaxherit dhe detyrimi për të njoftuar këto dhe dokumente të lidhura i nënshtrohen dispozitave ligjore. Menaxheri duhet të përgatisë pasqyrat vjetore financiare në përputhje me ligjin shqiptar dhe, pas përgatitjes, t'i paraqesë ato menjëherë në asamblenë e përgjithshme për miratim (pranim).

15.2. Asambleja e Përgjithshme vendos për përvetësimin e fitimit vjetor dhe lirimin e rezervave të cilat nuk konsiderohen më të nevojshme për Shoqërinë.

15.3. Fitimi neto i disponueshëm për shpërndarje do të shpërndahet midis mbajtësve të kuotave, në përputhje me vendimin e shpërndarjes. Fitimi neto për një vit financiar për t'u shpërndarë do të shpërndahet ndërmjet mbajtësve të kuotave në tërësi ose pjesërisht në një mënyrë të ndryshme nga norma e kontributeve të paguara në kapital në përputhje me nenin 21 më poshtë.

#### V. Ndryshime në strukturën e pronësisë

##### 16. E drejta e refuzimit të parë

16.1. Nëse ndonjë nga mbajtësit e kuotave dëshiron të shesë, transferojë ose ndryshe të heqë ndonjë ose të gjitha kuotat e tij/saj (kjo palë e quajtur "Shitësi"), mbajtësit e tjerë të kuotave ("Ofertuesit") do të kenë të drejtë parable për kuota të tilla ("Kuota të Ofruara") dhe sa më poshtë do të zbatohet:

16.2. Shitësi do të njoftojë me shkrim ofertuesit për dëshirën ose synimin e tij/saj për të shitur të gjithë ose ndonjë nga kuotat e tij/saj ndaj tyre. Ky njoftim do të dërgohet me postë rekomande drejtuar ofertuesve në adresat e vendosura pranë emrave të tyre në Shtojcën 4.1 të këtij statuti (ose në një adresë apo adresë të tjera që mund të njoftohet herë pas here me shkrim nga secili mbajtës i kuotave të tjera) ose duke e dërguar personalisht ndaj Ofertuesve dhe, nëse dërgohet me postë sikundër shprehur më lart, njoftimi do të konsiderohet se u është dhënë ofertuesve në ditën e dytë të punës pas dërgimit me postë. Ky njoftim ("Njoftimi i Shitjes") përmban:

- a. numrin e kuotave të zotëruara në përfitim të Shitësit;
- b. numrin dhe pjesën e kuotave që përbëjnë kuotat e ofruara, çmimin dhe kushtet e shitjes së kuotave të ofruara.

16.3. Nëse ndonjë nga mbajtësit e kuotave dëshiron të shesë, transferojë ose ndryshe të heqë ndonjë ose të gjitha kuotat e tij/saj brenda pesë viteve të para pas themelimit të Shoqërisë, çmimi i shitjes të Kuotave të tij/saj kufizohet në 70% të çmimit aktual. Çmimi aktual i Kuotave do të vendoset nga ekspertë të pavarur.

16.4. Çdo ofertues mund, brenda një periudhe gjashtë (6) mujore pas datës kur njoftimi i shitjes do të konsiderohet se është dhënë, të japë njoftim me shkrim ose me postë rekomande, drejtuar Shitësit në adresën e vendosur përballë emrit të tij / saj në Shtojcën 4.1 të këtij statuti (ose në një adresë tjetër që mund të





përcaktohet në Njoftimin e Shitjes) ose duke ia dërguar njoftimin personalisht Shitësit. Ky njoftim ("Njoftimi i Blerjes") do të përcaktojë gatishmërinë e një ofertuesi për të blerë kuotat e ofruara ose mungesën e gatishmërisë së tij/saj për të blerë kuotat e ofruara. Nëse një ofertues nuk jep njoftimin e blerjes do të konsiderohet se ai/ajo ka refuzuar të blejë kuotat e ofruara.

16.5. Pas marrjes nga Shitësi të çdo Njoftimi Blerje, ose pas përfundimit të gjashtë (6) muajve nga data e Njoftimit të Shitjes, cilado ndodh më herët, Shitësi do të jetë i detyruar të shesë të gjitha Kuotat e Ofruara tek Ofertuesit që kanë përcaktuar në Njoftimin e Blerjes se ata dëshirojnë të blejnë Kuotat e Ofruara ("Blerësit") me çmimin e përcaktuar dhe me kushte e përfshira në Njoftimin e Shitjes.

16.6. Nëse më shumë se një ofertues i ka dhënë një njoftim blerje shitësit duke përcaktuar gatishmërinë e tij/saj për të blerë kuotat e ofruara, atëherë, blerësit do të blejnë të gjitha kuotat e përmbajtura në Kuotat e Ofruara sipas pjesëve për të cilat mund të bien dakord, ose, në mungesë të një marrëveshjes, sipas Normave të Kuotave të Përbashkëta të secilit Blerës, të llogaritura pa iu referuar Kuotave të Shitësit.

16.7. Nëse ofertuesit për shkak të dispozitave të përmendura më lart, nuk blejnë kuotat e ofruara, atëherë Shitësi do të jetë i lirë të shesë kuotat e ofruara ndaj një të Jashtëmi, por vetëm me një çmim të barabartë ose më të lartë se çmimi i përcaktuar në njoftimin e shitjes dhe me të njëjtat kushte siç shpallen në njoftimin e shitjes. Nëse brenda nëntë (9) muajve të parë nga data e njoftimit të shitjes ose tre (3) muajve nga data ose marrja e njoftimit të fundit të blerjes nga shitësi i cili përcakton refuzimin e ofertuesve për të blerë kuotat e ofruara, Shitësi nuk ka marrë një ofertë të pakushtëzuar për të blerë kuotat nga një i jashtëm dhe nuk ka përfunduar shitjen e kuotave të ofruara ndaj një personi të jashtëm brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e marrjes së ofertës së pakushtëzuar, atëherë të drejtat e ofertuesve do të rikthehen në lidhje me kuotat e ofruara dhe nëse Shitësi pas kësaj dëshiron të shesë ndonjë nga Kuotat e tij/saj, ai/ajo përsëri do të japë njoftim në përputhje me paragrafin 5.2 dhe kështu me radhë sipas rasteve që paraqiten në mënyrë të herëpashershme. Shitësi do të dërgojë një kopje të Ofertës së Jashtëme tek Ofertuesit në përputhje me Paragrafin 5.2 para se të shesë Kuotat e Ofruara ndaj personit të Jashtëm.

16.8. Çdo ofertë për të blerë aksione nga një i jashtëm duhet të përfshijë kushtin që i jashtëmi të pranojë statutin e shoqërisë dhe të bie dakord të bëhet palë në çdo marrëveshje ndërmjet mbajtësve të kuotave dhe / ose investitorëve dhe / ose drejtorit menaxhues, etj., në përputhje me blerja e Kuotave.

16.9. Ky nen nuk do të zbatohet në rast se shitja e kuotave bëhet nga ndonjë prej mbajtësve të kuotave në favor të drejtorit menaxhues të Shoqërisë në përputhje me marrëveshjen, nëse ka, të lidhur midis mbajtësve të kuotave, drejtorit menaxhues, investitorëve etj. Në këtë rast, çmimi për kuotat do të jetë vlera nominale e kuotave. Në çdo rast, secili prej mbajtësve të kuotave është i detyruar të kryejë çdo veprim të nevojshëm për ta bërë transferimin efektiv, përfshirë dhënien e një vote pozitive në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose lëshimin e një njoftimi sipas të cilit heq dore nga e drejta e refuzimit të parë mbi kuotat.

## 17. Të drejtat e parablerjes

17.1. Pavarësisht sa shprehur në kundërshtim në statutin e Shoqërisë, sa vijon do të zbatohet për rritjen e kapitalit nga Shoqëria:

17.2. Nëse Shoqëria propozon të rrisë kapitalin e Shoqërisë ("Rritja e Kapitalit"), Rritja e Kapitalit do t'u propozohet mbajtësve të kuotave nga Asambleja e Përgjithshme në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria do t'i japë njoftim me shkrim ("Njoftimi") secilit prej mbajtësve të kuotave, duke përcaktuar vlerën e rritjes së kapitalit dhe kushtet sipas të cilave do të bëhet rritja e kapitalit.



17.3. Në njoftim do të përcaktohet koha në të cilën do të mbahet një mbledhja ("Mbledhja") e mbajtësve të kuotave për qëllimet e këtij neni 17 në zyrën qendrore të Shoqërisë me pjesëmarrjen virtuale që konsiderohet e pranueshme në një ditë e cila nuk do të më herët se dita e 15-të pas datës së dhënies së njoftimit, me kusht që nëse dita e 15-të është një e shtunë, e diel ose pushim kombëtar, data për Mbledhjen do të jetë dita e ardhshme e punës.

17.4. Secili mbajtës i kuotave që dëshiron të kontribuojë në Rritjen e Kapitalit mund të marrë pjesë në Mbledhje personalisht ose me anë të përfaqësuesit të tij/saj të caktuar rregullisht për këtë qëllim. Mbajtësi i kuotës që propozon të përfaqësohet në Mbledhje do të depozitojë te Drejtori Menaxhues i Shoqërisë në ose para Mbledhjes një dokument shkresor me anë të të cilit cakton përfaqësuesin, nëse dëshiron, një tjetër përfaqësues alternativ apo disa përfaqësues alternativë të autorizuar për të vepruar në emër të mbajtësit të kuotave në Mbledhje.

17.5. Kryetari i Mbledhjes dhe mund të vendos procedurat për zhvillimin e Mbledhjes nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij neni 18, sikundër ai/ajo i konsideron të përshtatshme për qëllimet e zbatimit të dispozitave të përmbajtura në Nenin 18.

17.6. Nëse mbajtësit e kuotave të përfaqësuar në Mbledhje e pranojnë ofertën e përcaktuar në njoftim, mbajtësit e kuotës do të japin kontributin në kapital në përputhje me njoftimin. Mbajtësit e kuotave do të kenë të drejtë të japin kontribute më të ulëta në rritjen e kapitalit kur e gjykojnë të përshtatshme dhe pjesëmarrja e tyre në kapitalin e Shoqërisë do të modifikohet përkatësisht.

17.7. Çdo rritje e kapitalit e cila nuk paguhet nga mbajtësit e kuotave në përputhje me Nenin 18 mund të ofrohet nga shoqëria ndaj një pale të tretë në të njëjtat kushte si në njoftim, me kusht që asnjë rritje kapitali të mos pranohet nga Shoqëria përveç se me pëlqimin me shkrim të mbajtësve të jo më pak se tre të katërtat e kuotave të zakonshme në kapitalin e Shoqërisë të papaguar deri në atë kohë.

18. Opsioni për blerje në rast vdekje apo aftësie të kufizuar

18.1. Në rast se një mbajtës i kuotës vdes ose vuan nga një paaftësi e përhershme mendore, kuotat e mbajtësit të kuotave të vdekur / me aftësi të kufizuara do të transferohet në pasurinë ose ndaj trashëgimtarëve ligjorë të mbajtësit të kuotës në fjalë, sipas paragrafit 19.2. Mbajtësit e tjerë të kuotave nuk do të kenë të drejtë të blejnë kuotat e mbajtësve të kuotave të vdekur / me aftësi të kufizuara nga pasuria e mbajtësit të kuotave në fjalë.

19. Kufizimet e transferimit, etj.

19.1. Asnjë mbajtës i kuotave, pa miratimin paraprak me shkrim të mbajtësve të kuotave të mbetura, nuk do të shesë, caktojë, transferojë, heqë, dhurojë, hipotekojë, premtojë, ngarkojë ose ndryshe barrësojë apo të ndërmarrë veprime lidhur me kuotat e tij/saj përveç se në përputhje me këtë Statut ose ndonjë marrëveshje, nëse ka, ndërmjet mbajtësve të kuotave, investitorëve dhe palëve të treta.

19.2. Në rast se në përputhje me ndonjë dispozitë të ndonjë marrëveshjeje, secili ose më shumë se një nga mbajtësit e kuotave do të shesin, caktojnë, transferojnë ose kalojnë ndonjë nga kuotat e tyre çdo personi, firmë ose korporatë tjetër të ndryshme nga palët në këtë Statut, transferimi në fjalë nuk do të bëhet ose do të jetë efektiv dhe asnjë kërkesë nuk do t'i bëhet Shoqërisë për të regjistruar transferimin në fjalë deri kur marrësi i propozuar të lidhë një marrëveshje me palët e tjera në këtë Statut për qëllimet e asaj marrëveshje dhe për çdo marrëveshje të ardhshme lidhur me Shoqërinë në të cilën transferuesi është pale.



## 20. Zgjidhja e Shoqërisë

20.1. Dispozitat e paragrafit 99 e vijues të ligjit për shoqëritë tregtare zbatohen për zgjidhjen e shoqërisë, por zgjidhja e shoqërisë kërkon një vendim unanim të mbajtësve të kuotave.

## VI. Shpërndarja e fitimit

### 21. Shpërndarja e fitimit

21.1. Fitimi neto i Shoqërisë i disponueshëm për shpërndarje do të shpërndahet si më poshtë, pavarësisht nga pjesëmarrja e mbajtësve të kuotave në kapitalin e Shoqërisë:

21.2. 30% e fitimit neto do të shpërndahet ndaj mbajtësve të kuotave SHKEJ dhe do të investohet në projekte sociale, sipas kontratës ndërmjet investitorit dhe mbajtësve të kuotave/shoqërisë.

21.3. pjesa e mbetur prej 70% të fitimit neto të Shoqërisë do të shpërndahet ndërmjet mbajtësve të kuotave përpjesëtimisht me pjesëmarrjet e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

## VII. Dispozita përfundimtare

### 22. Statuti

Nëse dispozitat individuale të këtij Statuti janë të pavlefshme ose nëse ky Statut përmban boshllëqe, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të mbetura. Në vend të këtyre dispozitave të pavlefshme, mbajtësit e kuotave marrin përsipër të punojnë për miratimin dhe përfshirjen në këtë Statut të dispozitave të vlefshme që pasqyrojnë më nga afër kuptimin dhe qëllimin e dispozitave të pavlefshme. Në rast të boshllëqeve, mbajtësit e kuotave marrin përsipër të punojnë për miratimin e një vendimi dhe përfshirjen në këtë statut të asaj dispozitës që korrespondon me atë që do të ishte rënë dakord në përputhje me kuptimin dhe qëllimin e kësaj marrëveshjeje nëse çështja do të kishte është konsideruar nga fillimi.

Datë: 15/02/2021

Datë: 15/02/2021

GRAGGER & CIE SOCIAL BUSINESS GMBH

SHKEJ

Përfaqësuar nga

përfaqësuar nga

(Firmë)

Përbërës: Stele Gjoka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER LORIANA A. ROBO



V2021050250080970650



DATE 02/03/2021  
NR REP 1002

**VËRTETIM PËRKTHIMI**

Sot, më datë 02/03/2021, para meje Noterit LORIANA A. ROBO, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën NR.5, ISMAIL QEMALI, NR.27, NR.1, NR.1, u paraqit personalisht:

**PËRKTHYES:**

**Stela Gjoka**, atësia Albert, amësia Dolores, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Kristal 04060080; Nd. 19; H. 2; Ap. 10; Golem; Kryemëdhej; 2504; Kavajë, lindur më 04/02/1987, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 033145623 dhe nr. personal I75204042D.

Përkthyesja është e licencuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur “Statut i Brum`ame”, nga gjuha angleze në gjuhën shqipe dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noterit.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”; në Republikën e Shqipërisë unë Noteri vërtetoj nënshkrimin e përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

LORIANA A. ROBO

